



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1329/1 Prot.

Tiranë, më 17.07.2026

V E N D I M

Nr. 196, datë 17.07.2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 168 Regj. datë 10.07.2026, të shtetasit H. V³, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, rezulton se H. V, 20 vjeç, është person me çrregullim të spektrit të autizmit dhe gjatë vitit shkollor 2023–2024, iu nënshtrua provimeve të Maturës Shtetërore në të njëjtat kushte dhe me të njëjtat procedura si të gjithë maurantët e tjerë, pa përfituar masa përshtatëse në përputhje me aftësinë e kufizuar.

Babai i subjektit ankues, si përfaqësues i tij pranë KMDsë, thekson se, duke filluar nga viti 2025, provimet e Maturës Shtetërore për maurantët me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe personat me çrregullim të spektrit të autizmit, u përshtatën për t’iu përgjigjur nevojave të kësaj kategorie. Sipas

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Përfaqësuar pranë KMD-së nga i jati z. R. V (sipas deklarimit të tij me shkrim)

tij, ky trajtim i ndryshëm dëshmon se djali i tij nuk ka përfituar nga këto masa gjatë zhvillimit të provimeve në vitin 2024.

Më tej, ankuesi shprehet se, si pasojë e rezultateve të arritura në provimet e Maturës Shtetërore, djali i tij ka rezultuar me mesatare të përgjithshme 6.4, ndërkohë që pragu minimal për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në institucionet e arsimit të lartë është 6.5. Për këtë arsye, ai pretendon se djali i tij është penalizuar dhe se nuk ka mundësi ligjore për të ripërsëritur provimet e Maturës Shtetërore me qëllim përmirësimin e rezultatit.

Në përfundim të ankesës, z. R. V i kërkon Komisionerit të ndërhyjë pranë autoriteteve kompetente, me qëllim që djali i tij të trajtohet si rast i veçantë dhe të mundësohet pranimi i tij në një program studimi të ciklit të parë (Bachelor), pavarësisht se mesatarja e arritur është 6.4.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton se ankuesi ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar dhe pasojat e tij në muajin qershor të vitit 2024, periudhë kur nxënësi H. V (person me aftësi të kufizuara, me çrregullim të spektrit autik) ka zhvilluar provimet e Maturës Shtetërore dhe janë publikuar rezultatet e tyre.

Duke qenë se data e depozitimit të ankesës nr. 168 Regj., pranë KMD-së është 10.07.2026, rezulton se nga momenti i marrjes dijeni për sjelljen diskriminuese të pretenduar e deri në datën e paraqitjes së ankesës kanë kaluar më shumë se 2 (dy) vjet.

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon se: *“Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”*, Komisioneri gjykon se ankesa është paraqitur në tejkalim të afatit ligjor të parashikuar në LMD. Në afatet e parashikuara në këtë dispozitë janë alternative dhe jo kumulative; për mospranimin e ankesës mjafton plotësimi i njërit prej tyre.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa është paraqitur tej afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për paraqitjen e ankesave pranë Komisionerit. Për rrjedhojë, ankesa nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri⁴.

Megjithatë, tejkalimi i afatit për paraqitjen e ankesës pranë Komisionerit nuk cenon të drejtën e subjektit ankues për t’iu drejtuar gjykatës kompetente, pasi afatet për ushtrimin e padisë në gjykatë janë të përcaktuara në mënyrë të veçantë në nenin 36, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Sipas pikës 3, të nenit 36 të këtij ligji, padia mund t’i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të ligjit, jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijeni për këtë sjellje. Për rrjedhojë, kalimi i afatit për paraqitjen e ankesës pranë Komisionerit nuk nënkupton kalimin e afatit për ushtrimin e padisë në gjykatë, pasi këto janë afate të ndryshme të parashikuara nga ligji.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

⁴ Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023, nr. 139, datë 26.07.2023, nr. 161, datë 09.06.2026, të Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 168, datë 10.07.2026, të paraqitur nga z. H. V⁵, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

⁵ Përfaqësuar nga babai, z. R. V.